

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Diddy mbetet pa avokat! Firma ligjore kërkon të tërhiqet, pretendon se reperi nuk ka paguar prej 6 muajsh - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/diddy-mbetet-pa-avokat-firma-ligjore-kerkon-te-terhiqet-pretendon-se-reperi-nuk-ka-paguar-prej-6-muajsh/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 12:12:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 12:11:01 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e1e10727e3d96b60d2b9ba2b4adf3aa68c3cd2ab33ce4058610d56562e5065bd
TEKSTI	6e1aed950cd6c34399c76f4f212e30d2277ed890849cbd3d7c18544fa274dbf6
PAMJA	0020a07c03166bf5672d2bea08c76ae4c5103fe395fff80ec659389b1db5d59e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3c5397cb257fb054405d0db13099664f5dbd3cc39266ec1918155bf163b4dd78
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c459fbdf88f453b54a4131a2c6b72ae8533f09b2deef09d60e250bd91e1b553d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3c5397cb257fb054405d0db13099664f5dbd3cc39266ec1918155bf163b4dd78>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Protesta në Tiranë Kuvendi i Shqipërisë Gjyqi i UÇK BE SHBA

BOTA

Diddy mbetet pa avokat! Firma ligjore kërkon të tërhiqet, pretendon se reperi nuk ka paguar prej 6 muajsh

17 Shtator 2026 | 14:11

Avokatët e Sean "Diddy" Combs kanë kërkuar zyrtarisht të tërhiqen nga përfaqësimi i tij në një padi për shpifje, duke pretenduar se producenti i muzikës u ka mbetur borxh për tarifat ligjore prej më shumë se gjashtë muajsh.

Sipas dokumenteve gjyqësore të siguruara nga Daily Mail, firma Sher Tremonte LLP ka paraqitur një mocion për t'u tërhequr nga çështja që Combs ka ngritur kundër Courtney Burgess, Ariel Mitchell dhe Nexstar Media Inc., kompania mëmë e NewsNation.

Avokati Michael Tremonte, partner në këtë firmë, pretendon se Combs ka krijuar "debitë të konsiderueshme" për shërbimet ligjore dhe se përfaqësimi i tij është bërë jashtëzakonisht i vështirë për shkak të mungesës së bashkëpunimit.

"Z. Combs ka debite të konsiderueshme ndaj Sher Tremonte për tarifat ligjore", shkroi Tremonte në dokumentet e dorëzuara në gjykatë.

Sipas avokatit, firma ka vijuar të ofrojë shërbime ligjore, ndërsa Combs nuk ka bërë asnjë pagesë për më shumë se gjashtë muaj. Pagesa e fundit, sipas dokumenteve, lidhej me tarifat dhe shpenzimet e krijuara në fund të vitit 2025.

Firma pretendon gjithashtu se një pjesë e konsiderueshme e shumës së papaguar përfshin fatura që kanë kaluar më shumë se 90 ditë pa u shlyer.

Por problemi nuk lidhet vetëm me paratë. Avokatët pretendojnë se mes tyre dhe Combs ka pasur një "ndërprerje të plotë të bashkëpunimit dhe komunikimit", duke thënë se ai nuk ka qenë i disponueshëm për më shumë se katër muaj për komunikim të drejtpërdrejtë dhe në kohë lidhur me çështjet e tij ligjore.

Sipas firmës, kjo situatë e ka bërë tepër të vështirë përfaqësimin e producentit dhe ka kufizuar aftësinë e avokatëve për t'i ofruar shërbime efektive.

Shiko në:

LAJMI I FUNDIT

14:06 Irani i përgjigjet Merzit: Gjermania po paraqet një narrativë "të shtrembëruar" për luftën dhe programin bërthamor

14:05 Theu masën e "arrestit në shtëpi" dhe kreu 16 vjedhje në lokale, arrestohet 34-vjeçari në Tiranë

14:02 Real Madridi "në garë" për sulmuesin 15-vjeçar të Manchester United, JJ Gabriel

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN

13:55 Alarmoi policinë për bombë në shkollën "Emin Duraku", Gjykata e Tiranës: Detyrim paraqitje për 47-vjeçarin

13:53 Nesër, protestë gjithëpopullore në Prishtinë

13:47 Ministria e re Shëndetësisë, Spahiu në Kuvend: Në 2027-ën ose do sjell PET Scan-in, ose do jap dorëheqjen

TESTIM

LAJME TË SUGJERUARA

BOTA

Irani i përgjigjet Merzit: Gjermania po paraqet një narrativë “të shtrembëruar” për luftën dhe programin bërthamor

Irani ka kundërshtuar deklaratat e kancelarit gjerman Friedrich Merz lidhur me programin bërthamor të Teheranit, aleatët e tij rajonalë dhe situatën në Lindjen e Mesme,...

14:06 | 17/09/2026

BOTA | EVROPA

Organizata Botërore Meteorologjike: Viti 2025, një nga vitet më të thata për lumenjtë në dekada

Organizata Botërore Meteorologjike, OBM ka deklaruar se viti 2025 ishte një nga vitet më të thata në dekada për lumenjtë në të gjithë botën. Më tej ajo...

13:45 | 17/09/2026

BOTA

Dronët ruse pranë kufirit ukrainas alarmojnë Poloninë, mbyllen 2 aeroporte dhe ngrihen avionët luftarakë

Aeroportet në Poloni kanë pezulluar fluturimet për shkak të sulmeve ruse pranë kufirit me Ukrainën perëndimore. Qeveria dërgoi gjithashtu një alarm për një kërcënim sulmi...

13:37 | 17/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni

Punësimi

Follow Euronews on all platforms: